



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.
___/07/2024

Patos, më

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje mbrojtëse individuale për punonjësit dhe veshmbathje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 18143000-3 - Veshje mbrojtëse

VLERA E FONDIT LIMIT: 18,339,976 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 182,833 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) Euro pa tvsh me kursin e kembimit te dates 28.06.2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrijmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçovë, QPN Fier dhe QPN Gorisht të cilat aktivitetin e tyre kanë nxjerrjen e naftës, arsye kjo pse pajisjet mbrojtëse individuale për punonjësit dhe veshmbathje, duhen të një lloji specifik.

Malli i kërkuar që prokurohet është i një kategorie që prodhohet dhe tregëtohet i gjithë malli lehtësisht nga operatorët në treg, të cilët kanë si fushë të veprimtarisë së tyre këtë objekt. Për këtë arsye procedura është menduar si një e tërë pa e ndarë në lote pasi pajisjet e kërkuara janë të gjitha për një qëllim dhe janë të një kategorie. Gjithashtu ndarja në lote mund të sillte vështirësi në pajisjen e të gjithë punonjësve me veshje pune dhe pajisje mbrojtëse dhe kosto të shtuara për AK.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Vërtetimi për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e parësor se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi të kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Në autorizim duhet të jetë i paraqitur Numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit (Adresë, website, email, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standarteve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqes katalog/skede teknike nga prodhuesi, për artikujt objekt i prokurimit. Katalogu/Skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike dhe standartin e kërkuar të artikujve që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skedën teknike të paraqitur të shenjojnë në mënyrë të dukshme të gjitha specifikimet teknike të mallit të ofruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te paraqesë perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese copë/palë për të gjithë artikujt, sipas tabelës së sasive.

Mostrat te paraqiten dhe te dorezohen ne zyren e protokoll arkives te Albpetrol sha Patos me seli ne rrugen Fier-Patos km 7, se bashku me nje dokument per paraqitje mostre te protokolluar ne Albpetrol sha, perpara afatit te fundit per paraqitjen e ofertave, ne menyre qe te jene ne dispozicion te Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

*Mostrat do te jene kofidenciale per sejcilin Operator Ekonomik dhe do ti kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 diteve nga data e lidhjes se kontrates me paraqitjen e nje kerkese prane AK nga ana e OE ofertues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter ndihmon AK në vlerësimin sa më të drejtë nga ana teknike të mallit të ofruar dhe shërben gjithashtu për të vërtetuar nëse malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe plotëson kërkesat e AK.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te paraqesë certifikatat e konformitetit per secilin nga artikujt e ofruar sipas certifikimeve/standarteve të kërkuara në shtojcën 5 “Specifikimet teknike”, ose ekuivalente me to.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter ndihmon AK në vlerësimin sa më të drejtë nga ana teknike të mallit të ofruar dhe shërben gjithashtu për të vërtetuar nëse malli i ofruar është në përputhje me standartet e kerkuara si dhe është në përputhje dhe i lidhur ngushte me objektin e prokurimit.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 mbi ”Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë , dhe këto kritere të vendosura janë në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse*

nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit: